



Datë: 27.05.2025
Numër Protokolli: 3789/2025

A.nr.504/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.504/2025, të datës 19.03.2025, të parashtruar nga ankuesja L.Sh., kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve të punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.504/2025, të datës 19.03.2025, e parashtruar nga ankuesja L.Sh., në atë mënyrë që **anulohet** Formuari i datës 28.02.2025, lidhur më vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024.

II. Obligohet Drejtori i Departamentit për Shërbime Shëndetësore dhe Shëndet Publik e Ministrisë së Shëndetësisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë rivlerësim të rezultateve në punë për ankuesen për periudhën, nga data 01.01.2024 deri me 11.11.2024.

III. Obligohet Ushtruesja e Detyrës e Drejtorit të Departamentit për Shërbime Shëndetësore dhe Shëndet Publik e Ministrisë së Shëndetësisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë rivlerësim të rezultateve në punë për ankuesen për periudhën, nga data 12.11.2024 deri me 31.12.2024.

IV. Obligohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë, që të ndërmarrin çdo veprim administrativ në kuptim të zbatimit të këtij vendimi sikurse është përcaktuar në pikën II dhe III të këtij dispozitivi.

V .Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, L.Sh. (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), më datë 19.03.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1820/2025 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 24.03.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2896/2025 të datës 30.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave(në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), **vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1820/2025 e datës 19.03.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës të datës 28.02.2025; E-mailin e datës 03.03.2025, me korrespondimet e bashkangjitura; E-mailin e datës 20.02.2025; E-mailin e datës 28.02.2025; E-mailin e datës 12.03.2024, me korrespondimet e bashkangjitura; Raportin për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Projekt Ligjit për Shëndet Mendor; Vendimin Nr.95/V/2024 të datës 03.05.2024; E-mailin e datës 19.04.2024; E-mailin e datës 19.04.2024; Vendimin Nr.63/IV/2024 të datës 04.04.2024; Vendimin Nr.55/IV/2024 të datës 04.04.2024; Vendimin Nr.56/IV/2024 të datës 04.04.2024; Vendimin Nr.78/IV/2024 të datës 04.04.2024; E-mailin e datës 06.12.2024; E-mailin e datës 13.12.2024; E-mailin e datës 13.12.2024; Vendimin Nr.299/IV/2024 të datës 25.04.2024; E-mailin e datës 8.08.2024; Vendimin Nr.719/X/ të datës 07.10.2024; E-mailin e datës 02.05.2024; E-mailin e datës 21.05.2025; E-mailin e datës 17.09.2024; E-mailat e datës 18.09.2024; E-mailin e datës 02.10.2024; E-mailin e datës 29.04.2024; E-mailin e datës 08.04.2024; E-mailin e datës 13.09.2024; E-mailin e datës 13.05.2024; E-mailin e datës 14.04.2024; E-mailin e datës 11.06.2024, me korrespondimet e bashkangjitura; E-mailin e datës 21.06.2024; Vendimin Nr.503/VII/2024 të datës 10.07.2024; Vendimin Nr.504/VII/2024 të datës 10.07.2024; Vendimin Nr.505/VII/2024 të datës 10.07.2024; E-mailin e datës 18.11.2024; E-mailin e datës 08.11.2024; E-mailin e datës 01.11.2024; E-mailin e datës 04.11.2024; E-mailin e datës 04.11.2024; E-mailat e datës 26.02.2024; E-mailin e datës 23.04.2024; E-mailin e datës 31.05.2024; E-mailin e datës 02.07.2024; E-mailin e datës 30.07.2024; E-mailin e datës 29.08.2024; E-mailin e datës 01.10.2024; E-mailin e datës 25.10.2024; E-mailin e datës 29.11.2024; E-mailin e datës 24.12.2024; Plani i veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i IAP/MKPT; E-mailin e datës 07.10.2024; E-mailin e datës 16.05.2024, së bashku me korrespondimet; E-mailin e datës 14.08.2024; E-mailin e datës 07.02.2025; Raportin e programit të terapisë mbajtëse me metadon; E-mailin e datës 20.02.2024, së bashku me korrespondimet; Shkresë e datës 23.02.2024; E-mailin e datës 21.08.2024, së bashku me korrespondimet; E-mailin e datës 13.08.2024; E-mailin e datës 14.08.2024; E-mailin e datës 06.08.2024; E-mailin e datës 16.05.2024; E-mailin e datës 08.01.2025; E-mailin e datës 15.01.2025; Vendimin Nr.22/2 të datës 14.02.2024; Vendimin Nr.307/2024 të datës 20.08.2024; E-mailin e datës 10.12.2024; E-mailat e datës 22.10.2024; E-mailin e datës 18.10.2024; E-mailin e datës 26.02.2024; E-mailin e datës 08.04.2024; E-mailin e datës 19.10.2024; E-mailin e datës 06.12.2024; E-mailin e datës 11.11.2024; E-mailin e datës 03.07.2024; E-mailin e datës 04.10.2024; E-mailin e datës 11.10.2024; E-mailin e datës 06.12.2024; E-mailin e datës 19.11.2024; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 11.02.2022, 11.01.2023 si dhe 04.03.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 16.04.2025; Akt emërimit me numër protokolli 05-10044 të datës 23.12.2024; Vendimin Nr.R.MSH 38/2024 të datës 11.11.2024; Akt emërimit me numër protokolli 05-10015 të datës 23.12.2024; Vendimin Nr.R.MSH 36/2024 të datës 11.11.2024; Vendimin me numër protokolli 05-8819 të datës 12.11.2024; E-mailin e datës 14.04.2025; E-mailin e datës 05.03.2025, së bashku me

korrespondimet; E-mailin e datës 04.03.2025, së bashku me korrespondimet; E-mailin e datës 28.10.2024, së bashku me korrespondimet; E-mailin e datës 30.09.2024; Raportin mujor të datës 02.07.2024; Raportin mujor të datës 30.08.2024; Raportin mujor të datës 03.01.2024; Raportin mujor të datës 03.06.2024; Raportin javor të datës 05.07.2024; Raportin javor të datës 02.08.2024; Raportin javor të datës 06.09.2024; Raportin javor të datës 08.07.2024; Raportin javor të datës 09.08.2024; Raportin javor të datës 16.08.2024; Raportin javor të datës 23.08.2024; Raportin javor të datës 30.08.2024; Raportin javor të datës 07.06.2024; Raportin javor të datës 17.05.2024; Raportin javor të datës 26.04.2024; Raportin javor të datës 09.02.2024; Raportin javor të datës 15.12.2023; Raportin javor të datës 05.01.2024; Raportin javor të datës 08.03.2024; Raportin javor të datës 12.04.2024; Raportin javor të datës 28.06.2024; Raportin javor të datës 12.01.2024; Raportin javor të datës 19.01.2024; Raportin javor të datës 22.03.2024; Raportin javor të datës 15.03.2024; Raportin javor të datës 26.01.2024; Raportin javor të datës 01.03.2024; Raportin javor të datës 24.05.2024; Raportin javor të datës 02.02.2024; Raportin javor të datës 03.05.2024.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesja është i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 05-100044 të datës 23.12.2024, mbanë pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit të Shëndetit Mendor* në Departamentin për Shërbime Shëndetësore dhe Shëndet Publik.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se Ushtuesja e Detyrës e Drejtorit të Departamentit për Shërbime Shëndetësore Publike, më datë 28.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesen për vitin 2024, dhe atë në nivel të përgjithshëm të vlerësimit “*Ka nevojë për përmirësim*”.

Ankuesja, në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton vlerësimin e rezultateve në punë të datës 28.02.2025, për shkak shkeljes së ligjit material dhe të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, ashtu që e njëjta propozon aprovimin e ankesës si të bazuar dhe hedhjen poshtë Vlerësimi i vitit 2024.

Kolegji i Këshillit lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike administrative ju referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenit 52: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësi të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të

rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunës/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësit që ka në vartësi. 9. Përrjashtimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme.

Kolegji i Këshillit për vendosja të drejtë mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë (në fuqi deri më datë 03.10.2024) dhe Rregulloren (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë (e cila është e aplikueshme nga data 04.10.2024), e të cilat akte ligjore rregullojnë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë.

Në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankueses dhe nga analizimi i shkresave të lëndës, konstatohet se Udhëheqësja e Divizionit të Shëndetit të Nënës dhe Fëmijës, ankuesen e ka vlerësuar për tërë vitin 2024 apo nuk ka specifikuar saktësisht periudhën kohore të vlerësimit të vitit 2024, mirëpo duke marrë parasysh se e njëjta është caktuar Ushtruese e Detyrës e Drejtorit të Departamentit për Shërbime Shëndetësore Publike, sipas Vendimit me numër protokolli 05-8819 të datës 12.11.2024, në këtë kuptim rrjedhë se e njëjta ka qenë mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e ankueses nga data e nënshkrimit të këtij akti, konkretisht nga data 12.11.2024, ndërsa bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht raportet javore dhe mujore të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, rezulton se e njëjta për vitin 2024 ka raportuar drejtpërdrejtë tek Drejtori i Departamentit të DShSSH Dr. Arsim Qavdarbasha, dhe si për rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se me këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 9, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 9. Përrjashtimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse; si dhe me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë dhe nenit 10 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, ku përcaktohet se: 5. Në rastet të ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secili mbikëqyrës vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse të mbikëqyrjes. NjMBNj siguron që mbikëqyrësi që ndërrohet, bën vlerësimin për periudhën përkatëse në përfundim të mbikëqyrjes., ngase në rastin përkatës rezulton se ankuesja gjatë vitit 2024 ka pasur dy mbikëqyrës të drejtpërdrejtë, ndërsa është vlerësuar vetëm nga Ushtruesja e Detyrës e Drejtorit të Departamentit për Shërbime Shëndetësore Publike.

Andaj, duke qenë se ankuesja për periudhën e kundërshtuar të vlerësimit ka pasur dy mbikëqyrës dhe atë nga data 01.01.2024 deri 11.11.2024, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë ka qenë Drejtori i Departamentit të DShSSH Dr. Arsim Qavdarbasha, ndërsa nga data 12.11.2024 deri më datë 31.12.2024, si mbikëqyrëse e ankueses ka qenë Udhëheqësja e Divizionit të Shëndetit të Nënës dhe Fëmijës, e caktuar Ushtruese e Detyrës e Drejtorit të Departamentit për Shërbime Shëndetësore Publike sipas Vendimit

me numër protokolli 05-8819 të datës 12.11.2024, kurse ankuesja është vlerësuar vetëm nga kjo e fundit për vitin tërë vitin 2024, Kolegji më qellim të kthimit të ligjshmërisë e në kuptim të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht mbi këto shkaqe nuk ka trajtuar pretendimet referuar argumentit të vlerësimit.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë—Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.504/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, L.Sh.;
- Organit të Punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.